



Përditësim

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Në çështjen gjyqësore për krime lufte, *Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi*, më 30 janar, Trupi Gjykses lejoi një viktimë pjesëmarrëse në proces që t'ia bënte të njohur statusin e vet si viktimë pjesëmarrëse një pale të tretë. Trupi Gjykses u pajtua se kjo ishte e domosdoshme dhe mori parasysh se masat mbrojtëse kundrejt publikut në përgjithësi janë ende në fuqi.

Më 3 shkurt, Trupi Gjykses lëshoi një vendim në të cilin konstatoi se dëshmia e një dëshmitari ishte e përshtatshme për t'u pranuar me shkrim pasi dëshmitari të jetë vënë në dispozicion për t'u marrë në pyetje nga pala kundërshtarë në gjykim. Trupi Gjykses autorizoi gjithashtu dëshmitarin të japë dëshmi nëpërmjet videolidhjes dhe urdhëroi Zyrën Administrative të bënte përgatitjet e nevojshme.

Trupi Gjykses theksoi se Mbrojtja nuk e kundërshtoi mocionin dhe se ai ishte bindur që pranimi i deklaratës së dëshmitarit në formë të shkruar nuk e dëmton padrejtësisht Mbrojtjen dhe gjithashtu do të kontribuojë në kryerjen e shpejtë të procesit, meqë do të shkurtojë kohëzgjatjen e pyetjeve të Prokurorisë nga katër orë në 45 minuta. Trupi Gjykses gjykoi se dhënia e dëshmisë përmes videokonferencës do të jetë më e favorshme për mirëqenien e dëshmitarit dhe njëkohësisht do të sigurojë fleksibilitet në planifikim, çka kontribuon në shpejtësinë e procesit.

Deri më sot 119 dëshmitarë kanë dhënë dëshmi në gjykatë në këtë çështje gjyqësore.

Seanca e ardhshme në këtë çështje gjyqësore është caktuar për të hënë, 10 shkurt, duke filluar në orën 9 paradite.





Në çështjen gjyqësore *Hashim Thaçi, Bashkim Smakaj, Isni Kilaj, Fadil Fazliu dhe Hajredin Kuçi* për ndikim të pretenduar ndaj dëshmitarëve, Kryetarja e Dhomave të Specializuara, gjykatëse Ekaterina Trendafilova, caktoi më 3 shkurt Panelin e Gjykatës së Apelit pasi Gjykatësja e Procedurës Paraprake i miratoi Prokurorisë leje të apelonte katër pika në lidhje me Vendimin mbi Konfirmimin e Aktakuzës nga Gjykatësja e Procedurës Paraprake, me të cilin konfirmoi pjesërisht akuzat kundër z. Thaçi, z. Smakaj, z. Kilaj, z. Fazliu dhe z. Kuçi. Prokuroria parashtroi se Gjykatësja e Procedurës Paraprake keqinterpretoi disa elemente të Kodit Penal të Kosovës. Paneli i Apelit përbëhet nga gjykatësit Mishelë Pikar, Emilio Gati, dhe Nina Jorgensen.

Më 30 janar, Administratorja njoftoi për caktimin e z. Aleksandër Admiral (Alexander Admiraal) si Mbrojtës të z. Kuçi.

Në çështjen gjyqësore Sabit Januzi, Ismet Bahtijari dhe Haxhi Shala, më 29 janar, Trupi Gjykses pranoi një viktimë për të marrë pjesë në këtë proces gjyqësor. Trupi Gjykses konstatoi se viktima pësoi dëm mendor në formë ankthi nga krimet e paraqitura në Aktakuzë. Megjithatë, Trupi Gjykses vendosi se kuadri i kufizuar i dëmit dhe faza e avancuar e procesit, ku seancat për pranimin e fajësisë janë mbajtur tashmë, nuk lejojnë pjesëmarrjen e plotë të viktimës nëpërmjet Mbrojtësit të Viktimave. Duke pasur parasysh dëmin mendor që pësoi viktima, Trupi Gjykses vendosi të merrte vendim për zhdëmtim, sado simbolik, që duhet t'i akordohet viktimës në këtë çështje gjyqësore. Palëve iu kërkua të dorëzonin versionet e rishikuara të marrëveshjeve për pranimin e fajësisë, përfshirë propozimet për zhdëmtime për t'iu akorduar viktimës, jo më vonë se të hënën, 3 shkurt 2025. Gjithashtu, Trupi Gjykses caktoi mbajtjen e një seance më 4 shkurt për të vendosur mbi marrëveshjet e pranimit të fajësisë të arritura midis Prokurorisë dhe të akuzuarve.

Më 4 shkurt 2025, Trupi Gjykses miratoi në seancë publike marrëveshjet për pranimin e fajësisë, ku të akuzuarit pranuan fajësinë për dy nga tri akuzat e konfirmuara kundër tyre nga Gjykatësja e Procedurës Paraprake. Më konkretisht, të akuzuarit pranuan fajësinë për një akuzë për pengim të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare





dhe një akuzë për frikësim gjatë procedurës penale. Prokuroria tërhoqi akuzën e tretë, pengim i personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare përmes të kërcënimit të rëndë, më 17 dhjetor 2024, në kuadër të marrëveshjeve për pranimin e fajësisë.

Secili prej të akuzuarve pranoi se ishte pjesë e një grupi që tentoi të nxiste një person që të mos jepte dëshmi para Dhomave të Specializuara përmes premtimit të një përfitimi. Konkretisht, Sabit Januzi dhe Ismet Bahtijari – me udhëzim të Haxhi Shalës – e kontaktuan këtë person në shtëpinë e tij, përkatësisht më 5 dhe 12 prill 2023.

Në bazë të marrëveshjeve për pranimin e fajësisë, Trupi Gjykses dënoi z. Haxhi Shala me tre vjet burgim dhe z. Januzi dhe z. Bahtijari me dy vjet burgim secilin, duke zbritur kohën e kaluar në paraburgim që prej arrestimit të të akuzuarve.

Të akuzuarit u pajtuan gjithashtu që t'i paguajnë shumën prej gjithsej 500 euro si zhdëmtim viktimës së pranuar për pjesëmarrje në proces.

Versionet e redaktuara publike të marrëveshjeve për pranimin e fajësisë gjenden në faqen e internetit të DHSK-së. Vendimi i arsyetuar do të lëshohet më vonë. Vendimi është i formës së prerë dhe rrjedhimisht nuk mund të apelohej.

